



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 441/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha Kryesues, Nenad Lazić dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) , paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga PREBK, me të cilën pretendohet se gjatë procesit të numërimit të votave janë dëmtuar ngase votat e tyre nuk janë numëruar në mënyrë të drejtë. Parashtruesi i ankesës thekson se ka fituar gjithsej 1033 vota kurse pas shpalljes së rezultateve nga QNR-ja, PREBK-ja ka pësuar rënie në 642 vota, qe do të thotë 391 vota me pak.

Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që pas shqyrtimit të kësaj ankesë të urdhëroi rinumërimin e të gjitha kutive të votimit në komunën e Prizrenit.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka prezantuar dhe as propozuar dëshmi të besueshme për të vërtetuar pretendimet ankimore se është bërë ndonjë parregullsi siç ka potencuar në ankesë, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Prandaj, PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar, kështu që nuk mund të pranohet as propozimi i ankesës që të numërohen votat e ankuesit në tërë komunën e Prizrenit.

Për arsyet e lartë përmendura, e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 441/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*